



**Prishtinë: 28.10.2011**

**Kodi i ZRRE-së: V\_382\_2011**

**Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_R\_675\_10\_11**

### **Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_R\_675\_07\_11**;

**Në mbledhjen e mbajtur më 28 tetor 2011 nxori këtë:**

#### **VENDIM**

**APROVOHET** ankesa e konsumatorit Zeqir Mermullaku (parashtruesi i ankesës Gëzim Mermullaku, shifra e konsumatorit në KEK: DPR - 90020054) nga Prishtina bazuar në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

#### **Arsyetim**

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 03.03.2009 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 19.02.2009 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 06.05.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektim të pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatori dhe kanë konstatuar se njehsori elektrik në anën majtë është liruar është futur filmi dhe është koqitur disku i njehsorit, ku është bërë e pamundur matja e energjisë së shpenzuar, njehsori nuk ka punuar.  
**Provë:** Procesverbali i kontrollës nr. 10144944 i datës 06.05.2008
- Me datë 21.05.2008 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR08HP05844 në vlerë prej 2947.68 €.  
**Provë:** Fatura DGL08HP01490 e datës 06.05.2008
- Me datë 07.02.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 21.11.2008 Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke thirrur në procesverbalin e kontrollës nr. 0144944 të datës 06.05.2008.  
**Provë:** Përgjigja e KEK-ut e datës 21.11.2008
- Me datë 03.03.2009 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në DMK

DMK, duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KEK-ut, ka vërejtur se:

- ✓ Punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektim të pikave matëse me datë 06.05.2008 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatori DPR – 90020054 dhe kanë konstatuar se gjatë inspektimit kanë hasur se nga ana e majtë e njehsorit elektrik nr. 11685823 është liruar dhe



është futur shiriti filmik, me ç'rast është koqitur disku i njehsorit elektrik dhe është bërë e pamundur regjistrimi i shpenzimit të energjisë elektrike.

**Provë:** Vërtetimi mbi ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 0144944 i datës 06.05.2008

- ✓ Pas këtij dyshimi të bërë nga punëtorët e KEK-ut, nuk është ndërmarr asnjë masë nga KEK-u për të bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, me qëllim që të dërgohet në qendrën e kalibrimit për verifikim të mëtutjeshëm. KEK-u menjëherë pas datës së kontrollës (06.05.2008) ka ngarkuar konsumatorin me rikthim të humbjeve sipas profilit të kabllit furnizues pa respektuar saktë procedurat për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike. Punëtorët e KEK –ut me rastin e inspektimit të njehsorit elektrik të datës 06.05.2008 kanë konstatuar se njehsori elektrik është liruar dhe se është futur shiriti filmik dhe se është koqitur disku i njehsorit elektrik, por që nuk kanë bërë asnjë fotografi lidhur me gjendjen e njehsorit elektrik. Punëtorët e kontrollës mund të dyshojnë se është futur shiriti filmik por që nuk mund të konstatojnë dhe se për këtë çështje nevojitet që njehsori elektrik të dërgohet për kontrollim detal.
- ✓ Sipas analizave të bëra rrjedhës së energjisë aktive mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike sipas viteve është: 2004 – 116 kWh/muaj; 2005 – 58 kWh/muaj; 2006 – 63 kWh/muaj; 2007 – 55 kWh/muaj; 2008 – 82 kWh/muaj; 2009 – 5 kWh/muaj; 2010 – 420 kWh/muaj. Sipas këtyre analizave të bëra rrjedhës së energjisë aktive vërehet se shpenzimi i energjisë së konsumatorit prej periudhës 08/2002 e deri te periudha e kontrollës nga KEK-u 05/2008 është 101 kWh, ndërsa mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike prej periudhës pas kontrollës 06/2008 e deri te periudha 12/2010 është 186 kWh/muaj.  
**Provë:** Rrjedha e energjisë aktive
- ✓ Mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike në sezonën dimërore të njehsorit elektrik nr. 11685823 para inspektimit nga KEK-u 05/2008 për periudhën 11/2007 – 03/2008 është 69 kWh/muaj, për periudhën 04/2006 – 09/2006 është 85 kWh/muaj, ndërsa pas inspektimit të KEK-ut mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike për periudhën 10/2008 – 3/2009 është 51 kWh/muaj dhe për periudhën 10/2009 – 03/2010 është 593 kWh/muaj.  
**Provë:** Rrjedha e energjisë aktive
- ✓ Sipas listave të leximit të KEK-ut, lexuesi i KEK-ut në listën e leximit të periudhës 05/2008 ka evidentuar se njehsori elektrik nevojitet për kontroll; në listën e leximit 01/2009 lexuesi i KEK-ut ka evidentuar se njehsori elektrik nevojitet për kontroll dhe se vula distributive është e dëmtuar; në listën e leximit të periudhës 02/2009 lexuesi i KEK-ut ka evidentuar se njehsori elektrik është në rregull dhe se vula distributive është në rregull; në listën e leximit të periudhës 03/2009 lexuesi i KEK-ut ka evidentuar se objekti i rrënuar.  
**Provë:** Listat e leximit të KEK-ut
- ✓ Me datë 23.10.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë dalur te konsumatori dhe kanë konstatuar se konsumatori ka rrënuar objektin ku ka qenë i vendosur njehsori me nr. 11685823 dhe se ka në atë vend ka ndërtuar një objekt tjetër dhe se ka vendosur njehsorin e ri.  
**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 395029 i datës 23.10.2009
- ✓ Me datë 19.11.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse dhe kanë evidentuar se konsumatori njehsorin nr. 11685823 nuk e prezanton ndërsa ka shënuar të dhënat e njehsorit elektrik nr. 45445885.  
**Provë:** Vërtetimi mbi ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 003032 të datës 19.11.2009
- ✓ KEK-u me rastin e llogaritjes së konsumatorit me shfrytëzim të paautorizuar (rikthim të humbjeve) fatura DGL08HP01490 e datës 06.05.2008, vërehet se KEK-u nuk ka gabuar me



rastin e llogaritjes së ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar. KEK-u nuk ka respektuar nenin 12 të procedurës së përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, ngase ka ngarkuar konsumatorin me shfrytëzim të paautorizuar duke marrë për bazë profilin e kabllit furnizues, ndërsa është dashur që KEK të merr pajisjet elektrike të inventarizuar në lokal.

**Provë:** Fatura DPR08HP05844 e datës 21.05.2008 dhe fatura nr. 673 e datës 20.05.2008

- ✓ Në ankesën e konsumatorit theksohet se lokali nuk punon një kohë të gjatë pasi nuk i plotëson as kushtet elementare për punë dhe se i njëjti është në procedurë të rrënimit. Lokali në fjalë i adaptuar në vitin 1988 dhe se i njëjti ka qenë garazh për automjet, dhe se ky lokal ka qenë në funksion kohë pas kohe deri para 2 viteve. Procesverbali i KEK-ut është bërë me datë 06.05.2008 dhe se çelësat e lokalit ja ka dhënë një punëtori të autolarjes e cila gjendet në pronë time për të lejuar punëtorët e KEK-ut të cilët e kanë shkruar procesverbalin e lartcekur dhe për të cilin nuk jam njoftuar deri para një muaji kur kam shkruar në KEK për të bërë kërkesë për shkyçje të njehsorit për të filluar rrënimin e objektit. Gjithashtu në ankesën e konsumatorit është theksuar se njehsori i rrymës është prodhim i vitit 1987 dhe se i njëjti posedon të gjitha bllokat dhe se dyshimi i KEK-ut ka qenë në ngjyrën e njehsorit.

**Provë:** Ankesa e konsumatorit

- ✓ Sipas analizave të dokumenteve të paraqitura vërehet se konsumatori objekti i konsumatorit është rrënuar në muajin 02/2009 dhe se kjo ka ndodhur pas inspektimit të ekipit të kontrollës dhe se tani është ndërruar veprimtaria e lokalit.

DMK pas analizave të bëra dëshmime dhe argumenteve të paraqitura, ka rekomanduar Bordin e ZRRE-së, që të **aprovojë** ankesën e konsumatorit dhe vjen të vjen në përfundim se:

1. KEK-u duhet të shkarkojë konsumatorin nga fatura e rikthimit të humbjeve DPR08HP05844 e datës 21.05.2008 në vlerë prej 2947.69€.

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet dhe argumentet e paraqitura dhe pas analizës së lëndës së konsumatorit ka vendosur që të **aprovojë** ankesën e konsumatorit për arsyet e paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së.

Sipas këtij vendimi, KEK-u është i obliguar që:

1. Të shkarkojë konsumatorin nga fatura e rikthimit të humbjeve DPR08HP05844 e datës 21.05.2008 në vlerë prej 2947.69€.



**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar

---

Enver Halimi, anëtar